Ndërmarrja Publike Lokale " Kastrioti " Sh.A
Lokalno Javno Produzeće " Kastrioti " D.D
Local Public Enterprise " Kastrioti " J.S.C
Obiliq
Datë: 27.01.2025 Nr. I Prot: I-120/25

Ndërmarrja Publike Lokale
KASTRIOTI Sh.A
Adresa: Rr. "Vashingtoni" pn - Obiliq
Tel: +383 46666607; +383 48777624
Email: nplkastrioti@gmail.com; web: www.nplkastrioti.com

Në bazë të nenit 8.1 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 si dhe bazuar në Udhëzimit Administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik NR.01/2024 të nenit 4.1, 5.1 dhe 5.2, në Statutin e Ndërmarrjes me nr prot 1888/24 të nenit 36 paragrafi 36.3 si dhe vendimit me nr protokolli I-113/25 datës 23.01.2025 Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A Obiliq me datën 27.01.2025 shpallë:

**KONKURS PUBLIK**

**Pozita: NDIHMËS KUZHINIER/E**
**Numri i punëtorëve: 2**
**Përgatitja shkollore:** Diploma e shkollës fillore apo të mesme
**Përvoja e punës:** e dëshirueshme
**Orari i punës:** i plotë
**Puna provuese:** 6 muaj
**Vendi:** Obiliq

**Shkathtësitë kyçe, njohuri, aftësitë e nevojshme:**
- Njohja e punës në gastronomi
- Të ketë aftësi të theksuar organizative

**Punët dhe detyrat e punës:**
- Përkujdeset për përgatitjen e ushqimit në Kuzhinën;
- Organizon dhe udhëheq punën në përgatitjen e llojeve të ndryshme të ushqimeve të ftohta dhe të ngrohta si dhe kujdeset që shërbimet në kuzhinë të jenë kryer me kohë;
- Në bashkëpunim me eprorin dhe udhëheqësin e njësisë së furnizimit, cakton blerjen e produkteve të nevojshme për përgatitjen dhe prodhimin e ushqimeve sa më kualitative;
- Në bashkëpunim me shefin e kuzhinës përcakton llojet e përgatitjes së ushqimeve ditore dhe futjen e tyre në meny;
- Kujdeset që ruajtjen e produkteve të kuzhinës në temperatura adekuate dhe kontrollin e tyre nga aspekti i afateve të përdorimit si dhe në rastet e prishjes së ushqimeve-daljes së afatit, kujdeset që i njëjti të hedhet sa më parë dhe të mos përdoret;
- Kujdeset për ruajtjen dhe magazinimin e rezervave të produkteve për përgatitjen e ushqimeve dhe paraqet me kohë kërkesat për blerjen e produkteve të nevojshme;
- Kujdeset që procesi i përgatitjes dhe prodhimit të ushqimeve të jetë sa më ekonomik dhe rentabil, duke shfrytëzuar në mënyrë të arsyeshme produktet dhe energjinë;
- Angazhohet në të gjitha pozitat në kuadër të njësisë së kuzhinës;
- Personalisht përgjigjet për mallin/produktet e pranuara nga njësia e furnizimit;
- Mbikëqyrë dhe kontrollon punën e të gjitha aparateve elektrike që shfrytëzohen në kuzhinë dhe në rast të defektit/prishjes, informon njësinë e mirëmbajtjes, për riparim sa më të shpejtë;
- Siguron që kuzhina dhe të gjitha pajisjet e kuzhinës gjatë përgatitjes dhe shërbimit të ushqimeve të jenë në gjendje funksionale dhe të gatshme dhe të përshtatshme për përdorim;
- Me qëllim të shmangies së fatkeqësive në punë, duhet që me kujdes të shtuar të përdor pajisjet;

Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A
Lokalno Javno Produzeće "Kastrioti" D.D
Local Public Enterprise "Kastrioti" J.S.C
I
Obiliq

- Përgjegjës për pranimin, ruajtjen dhe kontrollimin e mallit të pranuar si dhe në fillim të çdo muaji të përgatisë inventarizimin/regjistrimin;
- Kryen edhe punë të tjera profesionale, sipas kërkesës së eprorit, e të cilat janë në kuadër të veprimtarisë përkatëse të tij.
- Numërimi i shujtave dhe klasifikimi i tyre në bazë të numrit të fëmijëve;
- Të kryej edhe detyra të tjera të caktuara nga rregullorja e institucionit apo udhëheqësi.
- Për kryerje e detyrave i përgjigjet Kuzhinierit.

**Procedurat e Konkurrimit: Kandidati-ja për këto pozita duhet t'i dorëzojnë këto dëshmi:**

- **Dëshminë e kualifikimit,**
- **Dëshminë mbi përvojën e punës (e dëshirueshme)**
- **Ata që kanë trajnime në fushën përkatëse, kanë përparësi**
- **Kopjen e letërnjoftimit,**
- **Certifikatën nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (jo më e vjetër se 6 muaj),**
- **Aplikacionin për punësim, i cili merret në faqen e NPL "Kastrioti" Sh.A. (i nënshkruar).**

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen përmes e-mailit zyrtar: *konkursetnplkastrioti@gmail.com*
Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë vendbanimin, numrin e telefonit kontaktues dhe e-mail adresën.
Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për testin me shkrim.
Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

- **Konkursi është i hapur 15 ditë nga data e publikimit.**

"Kastrioti" Sh.A.
"Kastrioti" D.D.
J.S.C
Obiliq